



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr _____ Prot

Gramsh më _____.____.2025

P/V E N D I M

Nr ___ dt. . 01.2025

PËR

MIRATIMIN E BASHKËPUNIMIT TË BASHKISË GRAMSH ME FEDERATEN SHQIPTARE TË FUTBOLLIT TË PROJEKTIT ME OBJEKT “RIKONSTRUKSIONIN E STADIUMIT “MYSLYM KOÇI” E NGRITUR ME BAZA BASHKËFINANCIM 50/50 TË KËSAJ INFRASTRUKTURE NË QYTETIN E GRAMSHIT

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjet e tij të datës ___/___/2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për Miratimin e bashkëpunimit të Bashkisë Gramsh me Federaten Shqipëtare të Futbollit të projektit me objekt **“Rikonstruksionin e stadiumit “Myslym Koçi” e ngritur me baza bashkëfinancim 50/50 të kësaj infrastrukture në qytetin e Gramshit** mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per qeverisjen vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1/a 1.1/b, neni 23, neni 41, pika 2/ç, neni 54 pikat, e, g dhe k, Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar),

V E N D O S I

1. Të miratohet bashkëpunimi i Bashkisë Gramsh me Federaten Shqiptare të Futbollit të projektit me objekt “Rikonstruksionin e stadiumit “Myslym Koçi” e ngritur me baza bashkëfinancim 50/50 të kësaj infrastrukture në qytetin e Gramshit
2. Të miratojë vlerën e bashkëfinancimit nga Bashkia Gramsh për këtë objekt në masën 50 % të vlerës së investimit, për shumën totale **159 790 443.1** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë million e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e tre pike një) lekë me TVSH, pjesa takuese e Bashkisë Gramsh **79 895 221.55** (shtatëdhjetë e nëntë million e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet e një pike pesëdhjetë e pesë) lekë me TVSH e cila do të likujdhohet sipas një planifikimi me afat kohor 3 vjeçar.

Viti 2025 në shumën **8 000 000 lekë**
Viti 2026 në shumën **32 000 000 lekë**
Viti 2027 në shumën **39 895 221.55 lekë**

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Financës dhe buxhetit, dhe Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Keshillit

Xhulia GJINI



Kryetari i Keshillit të Bashkisë

Enis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 349 / prot

Gramsh, më 28/01/2025

P/V E N D I M

Nr. _____ datë, ___/___/ 2025

P Ë R

PËR NJË SHITESË NË LISTEN E INVENTARIT DHE KALIMIN NË PRONËSI TE BASHKISË GRAMSH TË PRONES ME ZK "TRUALL" ME NR 7/16 ME VENDODHJE NË QYTETIN GRAMSH BASHKIA GRAMSH E CILA DO PËRDORET PËR INTERES VENDOR.

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës, ___ / ___ / 2025, pasi mori në shqyrtim Relacionin dhe P/Vendimin nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar, nëni 3 të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, referuar VKM-së nr, 431 datë 11.07.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh të qarkut Elbasan i ndryshuar, të vendimit nr. 500 datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave "Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar, udhëzimit nr.15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësia e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike" Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronja "a", nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", me Propozimin të Kryetarit të Bashkisë Këshilli i Bashkisë.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e kërkesës për transferim të pronës me numër pasurie nr.7/16 me status juridik "Shtet" e cila ndodhet në qytetin e Gramshit, sipas planit të rievimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për interes vendor.
- II. Listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.07.2007 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, të shtohet prona me nr.7/16 me status juridik "Shtet" që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh.

Bashkia Gramsh

Lidhja nr, 1

Numri rendor i pronave në Listen e inventarit	Fusha e Përdorimit të Pronës	Lloji i transferimit
521	Interes Vendor	Në pronësi

Lista fillon me numrin rendor 521 (pesqind e njeze e nje) dhe përfundon me numrin rendor 521 (peseqind e njëzetë e një) dhe ka gjithsej 1 (një) fletë.

III.Bashkisë Gramsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1 ,të këtij vendimi , ta tjetërsojë ose t'ua jape në përdorim të tretëve .

IV .Paraqitja e materialit për miratimin në Këshillin e Ministrave .

V. Bashkëlidhur formularin nr.1 të inventarizimit .

VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Drejtoria e Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve Vendore Bashkia Gramsh .

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes !

SEKRETARI I KËSHILLIT**Xhulia GJINI****KRYETARI I KËSHILLIT****Enis ZANI**

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashki / Gramsh		Identifikoi:		Zamira Dymyshi (Specialiste /Kiste dhe Menaxhimit të Aseteve Vendore) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
Fusha e perdorimit te Prones:		Supervizoi:		Orgent Çoniku (Drejtor i Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
Interes Vendor		Aprovoi:		Besion Ajazi (Kryetar i Bashkisë) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)						
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	B			C			
				Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdonues Statusi juridik i perdonimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
521	1842 GR-F-3	7/16	Truall	Truall	3530.4m	0	Interes Vendor	Shtet	Shtet	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1842009063
(Nga ____, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1842, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 7/16, Sipërfaqja Totale 3530.4
m², (Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale GR-F-3, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia GRAMSH, Rruga __, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. __, Dt. 24/04/1997), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. __)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: P
Adresa e Pronarit: Bashkia Gramsh, Rruga __, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. __, Datë: 24/04/1997

Regjistruar: Nr. LN.03.1997, Datë: 24/04/1997

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____

Regjistruar: Nr. __, Datë: ____




REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENT I HARTES KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 1842
NUMRI I PASURISE : 7/16

KODI UNIK: 1842009063
INDEX I HARTES: GR-F-3
ADRESA E PASURISE : GRAMSH

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Shpetim Pasholla Digitally signed by: Shpetim Pasholla Date: 2024.10.29
Roland Llapushi Digitally signed by: Roland Llapushi Date: 2024.10.29

DREJTORI
ROLAND LLAPUSHI

SH 1:500

SHPJEGUESE
□ PARCELA
■ NDERTESA



Vulosur elektronikisht nga Zyra
Vendore Gramsh
Date: 2024/10/29 13:46:05 +02'00'
K47103817T2024102913455904014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Zyra Vendore Gramsh)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr _____ Prot

Gramsh më ____ .01.2025

RELACION
PËR
MIRATIMIN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TË VITIT 2024.

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , në ligjin nr .10296 datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” kreu 8 nenet 34-41, në ligjin Nr .68 /2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu IV “Transferta nga buxheti i shtetit dhe transferta te tjera” neni 22-30 kreu VII, neni 41 “ Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimi të buxhetit dhe procedurat e zbatimit të buxhetit për Rregulla dhe kriteret për përdorimin e buxhetit vendor", të Udhëzimit të Ministrit të financave dhe Ekonomise Nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" " dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të financave nr. 2 datë 24.01.2024 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të vitit 2025", vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 88 dt 27.12.2024 “ Për miratimin e programit buxhetor per vitin 2025”, vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 87 dt 27.12.2023 “ Për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar shtesë” paraqesim para Jush përdorimin e të ardhurave të trashëguara te vitit 2023.

Nga rakordimi i bërë me Degën e Thesarit Gramsh rezulton që të kemi një gjendje mjetesh monetare nga viti 2024 gjithsej **136,136,852.¹⁴** lekë .

Gjendja e mjeteve monetare të trashëguara është nga Granti pakushtëzuar është **34,888,614.⁸¹** lekë, gjendja e mjeteve monetare të trashëguara nga Granti specifik është **25,134,064.⁹⁰** lekë gjendja e mjeteve monetare të trashëguara nga nga të ardhurat e muajit dhjetor 2024 dhe ato të papërdorura për vitin 2024 është **34,975,067.³³** lekë, gjendja e mjeteve monetare të trashëguara është nga Granti pakushtëzuar shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024 është **22,080,820.⁰⁰** lekë, gjendja e mjeteve monetare të trashëguara nga të ardhurat e muajit janar 2025 por të klasifikuara nga sistemi i thesarit si të ardhura të periudhës buxhetore të vitit 2024 është **19,058,286.⁰⁰** lekë

Bazuar në faturat e pa likuiduara dhe kontratat e obliguara gjendje në thesar më 31.12.2023, në investimet dhe shërbimet e planifikuara të paprokuruar deri në 31.12.2023, në të ardhurat e papërdorura 2023 bëjmë shpërndarjen e fondeve të trashëguara sipas tabelës në bazë të programeve si më poshtë:

I. Të shtohen të ardhurat e trashëguara për Bashkinë (Programi 1110) dhe nga grandit i trashëguar shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024 në vlerën 111,002,788.¹⁴ 1 lekë:

Nr	Emërtimi	Fondi i trashëguar	Angazhimi	Mjete të lira	Vërejtje
1	Investime ,Mbikqyrje , Kolaudime, Studim projektim	22,447,965.95	4,241,737.00	18,206,228.95	Grant i trashëguar
2	Shpenzime Operative	12,440,648.86	5,222,319.00	7,218,329.86	Grant i trashëguar
3	Investime ,Mbikqyrje, Kolaudime	21,283,935.00	20,328,433.00	955,502.00	Me të ardhura trashëguara
4	Shpenzime Operative	13,691,132.33	9,593,379.00	4,097,753.33	Me të ardhura trashëguara
	Totali Bashkise	69,863,682.14	39,385,868	30,477,814.14	Fonde te lira

Nr	Emërtimi				Vërejtje
1	Grant i trashëguar shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024	22,080,820.00	21,785,572.00	295,248.00	
	Totali Bashkise	22,080,820.00	21,785,572.00	295,248.00	

Nr	Emërtimi				Vërejtje
1	Grant i trashëguar nga nga të ardhurat e muajit janar 2025 por të klasifikuara nga sistemi i thesarit si të ardhura të periudhës buxhetore të vitit 2024	19,058,286.00	0.00	19,058,286	
	Totali Bashkise	19,058,286.00	0.00	19,058,286	

II. Të përdoren mjetet monetare të lira për Bashkinë në shumën 30,477,814.¹⁴lekë e ndarë si mëposhtë:

Nga Granti i trashëguar 25,424,558.⁸¹ lekë.

1. Të përdoren për fond shtesë për pagat në shumën 16,499,681 lekë.
2. Të përdoren për bashkëfinancimin e rikonstruksionit të stadiumit “Myslim Koc” në shumën 8,000,000 lekë.
3. Të përdoren për blerje uniformash për policinë bashkiake në shumën 420,000 lekë
4. Të përdoren për Bashkëfinancime në shumën 141,714 lekë
5. Të përdoren për shpenzime operative vlera në shumën 363164.⁸¹ lekë

Nga të ardhurat e trashëguara 5,053,255.³³ lekë.

1. Të përdoren për organizimin e ceremonisë festive me rastin e 60 vjetorit të Themelimit të qytetit në shumën 2,000,000 lekë.
2. Të përdoren për shpenzimet e aktiviteteve të organizuara nga Qendra “Vëllezerit Çetiri” në shumën 1,053,255.³³ lekë
3. Të përdoren për financimin e shoqatës së Klubit shumësportësh “S.K. Gramsh” në shumën 2,000,000 lekë

III. Të përdoren mjetet monetare të përfituara nga Granti i trashëguar shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024 në shumën 22,080,8205 lekë “ Për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar shtesë” për mbulimin e shpenzimeve për detyrimet e prapambetura dhe projektet e investimeve të planifikuara por të palikujduara gjatë vitit 2024 si më poshtë

1. Të përdoren për mbulimin e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerën 3,989,392 lekë.
2. Të përdoren për mbulimin e detyrimeve të prapambetura për shpenzime furnizim interneti në vlerën 795,360 lekë.
3. Të përdoren për financimin e projektit Zgjerimi i varrezave te qytetit Gramsh në vlerën 4,920,578 lekë.
4. Të përdoren për financimin e projektit Ndertimi i prites Lumore Grike në vlerën 5,145,619 lekë.
5. Të përdoren për financimin e Mbikqyrjes së projektit Ndertimi i prites Lumore Grike në vlerën 154,369 lekë.
6. Të përdoren për financimin e Kolaudimit të projektit Ndertimi i prites Lumore Grike në vlerën 23,155 lekë.
7. Të përdoren për financimin e projektit Ndertimi i prites Lumore Pishaj në vlerën 5,371,772 lekë.
8. Të përdoren për financimin e Mbikqyrjes së projektit Ndertimi i prites Lumore Pishaj në vlerën 161,153 lekë.
9. Të përdoren për financimin e kolaudimit të projektit Ndertimi i prites Lumore Pishaj në vlerën 24,174 lekë.
10. Të përdoren për financimin e projektit Ndertimi i prites Lumore Bresnik në vlerën 1,200,000 lekë.
11. Diferenca e mbetur në vlerën 295,248 lekë të përdoren për fond shtesë për paga.

IV. Të përdoren mjetet monetare të përfituara nga të ardhurat e muajit janar 2025 por të klasifikuara nga sistemi i thesarit si të ardhura të periudhës buxhetore të vitit 2024 në vlerën 19,058,286 lekë si më poshtë

1. Vlerë e cila është e planifikuar në pasëyrën e të ardhurave të vitit 2025 në pasqyrën Nr 1 pika IV.5 në vlerën 16,200,000 të përdoren për financimin e projekteve si më poshtë:

a - Për financimin e projektit rikonstruksion asfaltim i rrugës fshati Qerret në vlerën 3,400,000 lekë.

b - Për financimin e projektit rikonstruksion asfaltim i rrugës fshati Trashovicë në vlerën 8,000,000 lekë.

c - Për financimin e projektit rikonstruksion asfaltim i rrugës fshati Drizë në vlerën 4,800,000 lekë.

2. Në Buxhetin e vitit 2025 të ulët parashikimi i të ardhurave në vlerën 16,200,000 lekë pasqyrën Nr 1 pika IV.5 respektivisht duke ulur shpenzimet për investimet e projekteve në emërtim dhe vlerë sipas pikës 1 (e mësipërme)

3. Vlera prej 2,858,286 lekë të përdoren për Bashkëfinancime.

V. Të shtohen të ardhurat e trashëguara për funksionet specifike në shumën 25,134,064 lekë.

Nr	Emërtimi	Fondi i trashëguar	Angazhim	Mjete të lira	Vërejtje
1	Arsimi Parashkollor	9,877,343.	1,466,352	8,410,991	Granti specifik
2	Arsimi i Mesem + Konvikti	6,212,444	1,752,604	4,459,840	Granti specifik
3	Ujitja dhe Kullimi	2,340,661	1,461,175	879,486	Granti specifik
4	Ndermarrja e Rrugeve	3,057,931	2,567,612	490,319	Granti specifik
5	Mbrojtja nga Zjarri	3,148,359	1,299,000	1,849,359	Granti specifik
6	Drejtoria Pyjore	497,326	497,326	0	Granti specifik
	Totali i trashëguar specifik	25,134,064	9,044,069	16,089,995	Fonde te lira

VI. Të përdoren fondet të lira për funksionet specifike nga grandit shuma 16,089,995 leke:

1-Të trashëguara nga grandit specifike për Arsimin Parashkollor janë në shumën 8,410,991 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 6,000,000 lekë.
- b. Të përdoret për shpenzime të aktivitetit të 80-vjetorit të shkollës 18 Gushti Shënmritzë në shumë 200,000 lekë
- c. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 1,010,991 lekë
- d. Blerje kompjutera dhe printera për institucionet vartëse në shumë 1,200,000 lekë

2-Të trashëguara nga grandit specifike për Arsimin Parauniversitar dhe Konvikti janë në shumën 4,459,840 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 500,000 lekë.
- b. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 3,959,840 lekë

3-Të trashëguara nga grandit specifike i Kullimit janë në shumën 879,486 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 100,000 lekë.
- b. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 779,486 lekë

4-Të trashëguara nga grandit specifike për Infrastruktura rurale dhe Konvikti janë në shumën 490,319 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 490,319 lekë.

5-Të trashëguara nga grandit specifike i Mrojtja nga Zjarri janë në shumën 1,849,359 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 100,000 lekë.
- b. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 1,749,359 lekë

Faleminderit.

**Drejtori Ekonomik
Ermal Hysa**

**Kryetari i Bashkise
Besion Ajazi**

Konceptoi: E.Carcu
Pranoi: E.Hysa
Konfirmoi: L.Zogu
Miratoi: E.Shahini
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr _____ prot

Gramsh _____.____.2025

P/V E N D I M

Nr dt. . . .2025

PER MIRATIMIN E TE ARDHURAVE TE TRASHEGUARA TË VITIT 2024.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës __.01.2025 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë “Për miratimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2023”, mbështetur në ligjin nr .10296 datë 08.07.2010 “ **Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë**”, në ligjin 139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 34-41, neni 54 shkronja dh”, në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.88 dt 27.12.2024 “ Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2024”, në akt- rakordimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2024 me Degën e Thesarit Gramsh .

V E N D O S I

I. Të shtohen të ardhurat e trashëguara për Bashkinë (Programi 1110) dhe nga granditë e trashëguara shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024 në vlerën 111,002,788.¹⁴ 1 lekë:

Nr	Emërtimi	Fondi i trashëguar	Angazhimi	Mjete të lira	Vërejtje
1	Investime ,Mbikqyrje , Kolaudime, Studim projektim	22,447,965.95	4,241,737.00	18,206,228.95	Grant i trashëguar
2	Shpenzime Operative	12,440,648.86	5,222,319.00	7,218,329.86	Grant i trashëguar
3	Investime ,Mbikqyrje, Kolaudime	21,283,935.00	20,328,433.00	955,502.00	Me të ardhura trashëguara
4	Shpenzime Operative	13,691,132.33	9,593,379.00	4,097,753.33	Me të ardhura trashëguara
	Totali Bashkise	69,863,682.14	39,385,868	30,477,814.14	Fonde te lira

Nr	Emërtimi				Vërejtje
1	Grant i trashëguar shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024	22,080,820.00	21,785,572.00	295,248.00	
	Totali Bashkise	22,080,820.00	21,785,572.00	295,248.00	

Nr	Emërtimi				Vërejtje
1	Grant i trashëguar nga nga të ardhurat e muajit janar 2025 por të klasifikuara nga sistemi i thesarit si të ardhura të periudhës buxhetore të vitit 2024	19,058,286.00	0.00	19,058,286	
	Totali Bashkise	19,058,286.00	0.00	19,058,286	

II. Të përdoren mjetet monetare të lira për Bashkinë në shumën 30,477,814.¹⁴lekë e ndarë si mëposhtë:

A Nga Granti i trashëguar 25,424,558.⁸¹ lekë.

6. Të përdoren për fond shtesë për pagat në shumën 16,499,681 lekë.

7. Të përdoren për bashkëfinancimin e rikonstruksionit të stadiumit “Myslim Koc” në shumën 8,000,000 lekë.

8. Të përdoren për blerje uniformash për policinë bashkiake në shumën 420,000 lekë

9. Të përdoren për Bashkëfinancime në shumën 141,714 lekë

10. Të përdoren për shpenzime operative vlera në shumën 363164.⁸¹ lekë

B Nga të ardhurat e trashëguara 5,053,255.³³ lekë.

1. Të përdoren për organizimin e ceremonisë festive me rastin e 60 vjetorit të Themelimit të qytetit në shumën 2,000,000 lekë.

2. Të përdoren për shpenzimet e aktiviteteve të organizuara nga Qendra “Vëllezerit Çetiri” në shumën 1,053,255.³³ lekë

3. Të përdoren për financimin e shoqatës së Klubit shumësportësh “S.K. Gramsh” në shumën 2,000,000 lekë

III. Të përdoren mjetet monetare të përfituara nga Granti i trashëguar shtesë me aktin normativ nr 5 date 19.12.2024 në shumën 22,080,8205 lekë “ Për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar shtesë” për mbulimin e shpenzimeve për detyrimet e prapambetura dhe projektet e investimeve të planifikuara por të palikujduara gjatë vitit 2024 si më poshtë

1 Të përdoren për mbulimin e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerën 3,989,392 lekë.

2 Të përdoren për mbulimin e detyrimeve të prapambetura për shpenzime furnizim interneti në vlerën 795,360 lekë.

- 3 Të përdoren për financimin e projektit Zgjerimi i varrezave te qytetit Gramsh në vlerën 4,920,578 lekë.
4. Të përdoren për financimin e projektit Ndertimi i prites Lumore Grike në vlerën 5,145,619 lekë.
5. Të përdoren për financimin e Mbikqyrjes së projektit Ndertimi i prites Lumore Grike në vlerën 154,369 lekë.
6. Të përdoren për financimin e Kolaudimit të projektit Ndertimi i prites Lumore Grike në vlerën 23,155 lekë.
7. Të përdoren për financimin e projektit Ndertimi i prites Lumore Pishaj në vlerën 5,371,772 lekë.
8. Të përdoren për financimin e Mbikqyrjes së projektit Ndertimi i prites Lumore Pishaj në vlerën 161,153 lekë.
9. Të përdoren për financimin e kolaudimit të projektit Ndertimi i prites Lumore Pishaj në vlerën 24,174 lekë.
10. Të përdoren për financimin e projektit Ndertimi i prites Lumore Bresnik në vlerën 1,200,000 lekë.
11. Diferenca e mbetur në vlerën 295,248 lekë të përdoren për fond shtesë për paga.

IV. Të përdoren mjetet monetare të përfituara nga të ardhurat e muajit janar 2025 por të klasifikuara nga sistemi i thesarit si të ardhura të periudhës buxhetore të vitit 2024 në vlerën 19,058,286 lekë si më poshtë

1. Vlerë e cila është e planifikuar në pasëyrën e të ardhurave të vitit 2025 në pasqyrën Nr 1 pika IV.5 në vlerën 16,200,000 të përdoren për financimin e projekteve si më poshtë:
 - a - Për financimin e projektit rikonstruksion asfaltim i rrugës fshati Qerret në vlerën 3,400,000 lekë.
 - b - Për financimin e projektit rikonstruksion asfaltim i rrugës fshati Trashovicë në vlerën 8,000,000 lekë.
 - c - Për financimin e projektit rikonstruksion asfaltim i rrugës fshati Drizë në vlerën 4,800,000 lekë.
2. Në Buxhetin e vitit 2025 të ulet parashikimi i të ardhurave në vlerën 16,200,000 lekë pasqyra Nr 1 pika IV.5 respektivisht duke ulur shpenzimet për investimet e projekteve në emërtim dhe vlerë sipas pikës 1 (e mësipërme)
3. Vlera prej 2,858,286 lekë të përdoren për Bashkëfinancime.

V. Të shtohen të ardhurat e trashëguara për funksionet specifike në shumën 25,134,064 lekë.

Nr	Emërtimi	Fondi i trashëguar	Angazhim	Mjete të lira	Vërejtje
1	Arsimi Parashkollor	9,877,343.	1,466,352	8,410,991	Granti specifik
2	Arsimi i Mesem + Konvikti	6,212,444	1,752,604	4,459,840	Granti specifik
3	Ujitja dhe Kullimi	2,340,661	1,461,175	879,486	Granti specifik
4	Ndermarrja e Rrugeve	3,057,931	2,567,612	490,319	Granti specifik
5	Mbrojtja nga Zjarri	3,148,359	1,299,000	1,849,359	Granti specifik
6	Drejtoria Pyjore	497,326	497,326	0	Granti specifik
	Totali i trashëguar specifik	25,134,064	9,044,069	16,089,995	Fonde te lira

VI. Të përdoren fondet të lira për funksionet specifike nga grandit shuma 16,089,995 leke:

1-Të trashëguara nga grandit specifik për Arsimin Parashkollor janë në shumën 8,410,991 lekë.

- i. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 6,000,000 lekë.
- j. Të përdoret për shpenzime të aktivitetit të 80-vjetorit të shkollës 18 Gushti Shënmrizë në shumë 200,000 lekë
- k. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 1,010,991 lekë
- l. Blerje kompjutera dhe printera për institucionet vartëse në shumë 1,200,000 lekë

2-Të trashëguara nga grandit specifik për Arsimin Parauniversitar dhe Konvikti janë në shumën 4,459,840 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 500,000 lekë.
- b. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 3,959,840 lekë

3-Të trashëguara nga grandit specifik i Kullimit janë në shumën 879,486 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 100,000 lekë.
- b. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 779,486 lekë

4-Të trashëguara nga grandit specifik për Infrastruktura rurale dhe Konvikti janë në shumën 490,319 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 490,319 lekë.

5-Të trashëguara nga grandit specifik i Mbrojtja nga Zjarri janë në shumën 1,849,359 lekë.

- a. Të përdoret për shpenzime për paga dhe sig shoqërore në shumë 100,000 lekë.
- b. Të përdoren për shpenzime operative në shumë 1,749,359 lekë

VII. Të ardhurat për Qarkun janë 1% e të ardhurave vjetore 2024.

- VIII.** Të gjitha veprimet të pasqyrohen në instrumentin e FPT-së për vitin 2024.
- IX.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
- X.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Keshillit
Xhulia Gjini**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak
Enis Zani**

Konc.Dakt.Xh.Gjini
Miratoi. E.Zani
Konfirmoi. E.Zani
Dosja_____

Afati_____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 345 prot.

Gramsh, më 28/01/2025

RELACION

“Për disa ndryshime në Vendim e Këshillit Bashkiak nr.86 datë .27.12. 2024 “ Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave e shpërblimeve, të punonjësve e personave, të emëruar osë të zgjedhur të Bashkisë Gramsh, për vitin 2025”

Të nderuar këshilltarë,

Reforma e ristrukturimit dhe rritjes së pagave për pushtetin vendor ka përfshirë të gjitha bashkitë e vendit. Reforma përfshin ndryshimin e strukturave organizative të secilës bashki dhe përafrimin e këtyre strukturave sipas kategorive të bashkive nisur nga numri i banorëve. Struktura të ngjashme, janë propozuar sipas Manualit Orientues “Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i cili u është dërguar të gjithë bashkive nga Ministri për Pushtetin Vendor , që të rikostruktohen me tri nivele stafesh me strukturë që merret planifikim dhe projektim, struktura që është përgjegjëse për zbatimin e punëve të bashkisë, kategoria e tretë e agjencisë së shërbimeve janë ato funksione që disa shërbime i zgjedh t’i bëjë vetë, ose të zgjedhë palë të treta me kontraktim. Kjo strukturë do të ndihmojë për të evidentuar performacën e bashkive dhe ndarjen e fondit nga qeveria. Reforma për pushtetin vendor, lindi si një nevojë për shkak të mungesës së punonjësve në disa bashki të vendit, duke sjellë mangësi në kryerjen e shërbimeve thelbësore.

Me vendimin e Kryetarit të bashkisë nr. 4 datë 21.01.2025 është miratuar struktura e bashkisë Gramsh dhe njësite në varësi të saj, duke iu referuar Manualit Orientues “Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i cili u është dërguar bashkive nga Ministri për Pushtetin Vendor është parashikuar modeli i strukturës për 61 bashkitë e vendit bazuar në numrin e popullsisë dhe në mënyrë të integruar me vendimin e ri të pagave në nivel vendor, duke i shërbyer përmirësimit të përzgjedhjes dhe rekrutimeve të profesionistëve, Sipas Manualit i reflektuar në strukturën e miratuar është organizuar në 3 nivele dhe që mbulohen të gjitha funksionet që legjisllacioni në fuqi u ngarkon njësite të vetëqeverisjes vendore , dhe për këtë arsye kërkohet një rritje shtesë e burimeve njerëzore .

Sic edhe kemi relatuar në mbledhjen e fundi të këshillit bashkiak se në janar të vitit 2025 do të impementohet struktura e re organizative sipas manualit dhe referuar tij kërkohen disa shtesa në sektorë të ndryshëm , për përmbushjen e të gjitha funksioneve të vetëqeverisjes vendore dhe që do të shoqërohet me një rritje të numrit të punonjësve ashtu .Kërkohe një shtesë prej 2(dy) punonjësish me qëllim implementimin e strukturës së re sipas fushës së veprimtarisë së këtyre sektorëve.

Sipas strukturës së re të miratuar janë krijuar sektorë , drejtori , agjenci referuar Manualit të Strukturave dhe Organikave dhe për implementimin e strukturës së re kërkohet një shtesë punonjësish prej 2 punonjësish, që konsistojnë në drejtorë agjencish.

Kjo strukturë e miratuar do të ndikojë në përmbushje të misionit të vetëqeverisjes vendore sipas të cilit cdo Bashki duhet të sigurojë një qeverisje efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve në shërbim të tyre..

Gjithashtu propozojmë një rritje page për dy përgjegjësat e dy sektorëve, konkretisht të Sektorit të Shërbimeve Publike, ndricimit publik, mirëmbajtjes së objekteve arsimore e publike si dhe përgjegjësit të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore , për shkak të ngarkesës në punë , vështirësisë në punë, që për shkak të kompleksitetit të punëve në terren janë të detyruar të punonjnë edhe jashtë orarit si dhe ditëve të pushimit, dhe një rritje e pagës do të ndiokonte tek ata në kryerjen më me motivim dhe përgjegjshmëri.

Ju ftojme të nderuar këshilltarë, të diskutojmë duke miratuar projekt-vendimin e paraqitur, bashkëlidhur këtij relacioni.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 345 / prot.

Gramsh, më 28/01/2025

P/V E N D I M

Nr. _____, Datë ___/___/2025

PËR

Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.86 datë 27.12.2024“ Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave e shpërblimeve, të punonjësve e personave, të emëruar osë të zgjedhur të Bashkisë Gramsh”.

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës ___/___/2025, pasi shqyrtoi relacionin “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.86 datë 27.12.2024 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave e shpërblimeve, të punonjësve e personave, të emëruar osë të zgjedhur të Bashkisë Gramsh” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 pika “ç” dhe “dh”; Ligji Nr.152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” (i ndryshuar); Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; Ligjit nr.89/2022 “Për policinë bashkiake”, VKM nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kulfijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore” të Këshillit të Ministrave, Vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të Këshillit të Ministrave,; Vendimit nr. 421 datë 26.06.2024 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabinetit, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të Këshillit të Ministrave;Vendimit nr. 425 datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor

parauniversitar”, të Këshillit të Ministrave; Vendimit nr.419 datë 26.06.2024 “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të Këshillit të Ministrave; Shkresës nr.5646 datë 06.12.2024 “Kthim përgjigje kërkesës për interpretim të VKM-së nr.328/2023, të ndryshuar

V E N D O S I :

1. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve vartëse të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.86 datë 27.12.2024 , të bëhet një shtesë prej 2(dy) punonjësish.
2. Të miratojë ndryshimin e nivelit të pagave të punonjësve për pikat 16.2 dhe 17.3 të strukturës për pozicionet si më poshtë :

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës	Kategoria	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
Sektori i Shërbimeve Publike, ndricimit publik, mirëmbajtjes së objekteve arsimore e publike				
1	Përgjegjës	III-2, L.6	1	90000
Sektori i zhvillimit rural dhe infrastrukturës rrugore				
2	Përgjegjës	III-2, L.6	1	90000

3. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2025.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË ASETVE VENDORE

Nr. 349 prot

Gramsh, më 29.09/2025

RELACION

PËR

PËR NJË SHITESË NË LISTEN E INVENTARIT DHE KALIMIN NË PRONËSI TE BASHKISË GRAMSH TË PRONES ME ZK "TRUALL" ME NR 7/16 ME VENDODHJE NË QYTETIN GRAMSH BASHKIA GRAMSH E CILA DO PËRDORET PËR INTERES VENDOR.

Ne mbështetje te neneve 13 e 15, te ligjit nr.8743 date 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit " të ndryshuar ; ligjit nr.8744, date 22.02.2001. "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në Njesitë e Qeverisjes Vendore" neneve 3,5,7, 18, i ndryshuar si dhe VKM Nr.500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Publike Shtetërore dhe Transferimin e pronave në Njesite e Qeverisjes Vendore ", Udhezimit nr.15 date 30.06.2003 "Per menyren e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore te kerkesave per transferim ne pronesi te tyre te pronave te paluajtshme publike ;VKM-së nr. 431 datë 11.07.2007 " Për miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te bashkise Gramsh ,të qarkut Elbasan" Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronja "a", nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" paraqesim perpara Keshillit te Bashkise projekt vendimin perkates duke ju sqaruar si me poshte.

Përshkrimi i situates së objektit :

Pasuria 7/16 me ZK "truall" e cila ndodhet në qytetin e Gramshit nevojitet per investime qe do te kryeje Bashkia Gramsh prandaj lind nevoja të kerkojme transferimin e truallit në pronësi të Bashkisë Gramsh edhe pronën në Bashkinë Gramsh per interes vendor.

Për këtë arsye kërkojme që :

Pasuria nr.7/16, është truall me siperfaqe totale $S= 3530.4m^2$ sipas formularit nr.1 per inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore .

Bashkëlidhur një kopje të dokumentacionit .

Për te vazhduar procedurat e nevojshme sipas legjistacionit ne fuqi qe t'i trajtojme në Keshillin e Bashkise , e me pas ne Keshillin e Ministrave kerkohet miratimi nga ana juaj.

Për sa me siper propozojme :

1. Të shtohet në inventarin e pronave të palujtshme publike shtetërore në Juridiksionin teritorial dhe administrativ ne pronesi të bashkise Gramsh , prona me numër inventari 521 sipas formularit nr.1 bashkëlidhur .

Bashkia Gramsh

Lidhja nr, 1

Numri rendor i pronave në Listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
521	Interes Vendor	Në pronësi

Lista fillon me numrin 521 (pesëqindë e njëzet e një) dhe përfundon me numrin rendor 521 (peseqindë e njeze e një) dhe ka gjithsej 1 (një) fletë.

2.Ti propozohet Këshillit të Ministrave të bëje ndryshimet përkatëse referuar VKM nr. 431 datë 11/07/2007 “Për miratimin e listes përfundimtare të pronave të palujtshme publike , shtetërore që transferohen në pronesi ose në përdorim të bashkisë Gramsh ,të qarkut Elbasan”

Sa më lartë ne i propozojmë Këshillit të Bashkisë të miratoje Relacionin dhe P/Vendimin e paraqitur nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve Vendore Bashkia Gramsh .

Duke ju falenderuar për mirkuptimin tuaj !

KRYETARI I BASHKISË

Besion AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, STREHIMIT DHE KOORDINIMIT ME
NJA-të
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr. 317 prot.

Gramsh, më 28/01/2025

Relacion

Për miratimin e kërkesave për përfitimin e granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese për disa familje në nevojë, bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në ligjin nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, në VKM nr. 454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, bashkia Gramsh ka ndërmarrë të gjitha hapat e saj për të përfituar nga programet sociale të strehimit.

Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për financimin e plotë ose të pjesshëm të projekteve që propozohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për:

- a) përmirësimin e kushteve të banimit dhe jetesës, deri në ndërtim të ri, në banesat në rrezik shembjeje;
- b) përmirësimin e kushteve të banimit në banesat e amortizuara, për familjet që në përbërje të tyre kanë persona me aftësi të kufizuar, me qëllim që përmirësimi të lehtësojë shkallën e përshtatshmërisë e të plotësimit të nevojave të veçanta të banimit për ta;
- c) rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat nuk klasifikohen si banesë, për familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin, veçanërisht për familje të minoriteteve romë dhe egjiptiane, vetëm për një periudhë dy vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si dhe për familje të zonave rurale.

Ministria përgjegjëse për strehimin shpall në faqen e vet të internetit dhe fton, nëpërmjet një thirrjeje publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore që të paraqesin kërkesat e tyre për grante konkurruese.

Thirrja për aplikime përmban:

- a) tematikën e projekteve;
- b) kushtet për financim;

- c) kriteret e pikëzimit;
- ç) afatet e dorëzimit;
- d) formatet e aplikimit.

Aplikimi i njësive të vetëqeverisjes vendore për grant konkurrues për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese përmban:

- a) studimin e zonës, planin urbanistik,;
- b) certifikatën e pronësisë mbi tokën,;
- c) relacionin mbi vlerësimin e kostove, eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të grantit, kohëzgjatjen e përshtatjes, vlerësimin e riskut;
- ç) planvendosjen e objektit, shoqëruar me distancat nga pikat kryesore të qytetit dhe shërbimet bazë;
- d) të dhëna teknike, si sipërfaqja e objektit, numri i apartamenteve dhe përshkrimi i llojit të ndërhyrjeve për përshtatje;
- dh) projektin teknik të ndërhyrjes për përshtatje;
- e) kategoritë e familjeve të synuara.

Për sa më sipër komisioni përkatës për strehimin pranë bashkisë Gramsh , pasi ka shqyrtuar rastet e familjeve të cilat kanë aplikuar për të përfituar nga programet e strehimit, të cilat plotësojnë të gjitha kriteret e nevojshme ligjore për kualifikim.

Ka kryer verifikimet përkatëse në terren dhe ka hartuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të cilën duhet ta përmbajë dosja e aplikimit e cila do të dorëzohet pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Familjet të cilat kanë aplikuar për të përfituar nga programi për përmirësimin e banesave ekzistuese janë si më poshtë:

1. **Agim Zyfer Hoxholli** ,banues në fshatin Kodovjat ,Njësia Administrative Kodovjat ,familje e përbërë nga 3 anëtarë, të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.Dy vajzat e z.Agim trajtohen me PAK.
Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 1 599 955.32 lekë.
2. **Agron Murat Cani** ,banues në fshatin Bërsnik ,Njësia Administrative Kodovjat,familje e përbërë nga 2 anëtarë të dy penionistë. Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë pensioni.Vlera e preventivittë hartuar e banesës është 999 963.82 lekë.
3. **Ardian Qemal Shahini** banues në fshatin Kodovjat ,Njësia Administrative Kodovjat ,familje e përbërë nga 4 anëtarë, nga të cilët dy janë invalid.Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 1 399 941 lekë.
4. **Hamide Zenel Dervishi** banuese në fshatin Bërsnik, Njësia Administrative Kodovjat, familje e përbërë nga 6 anëtarë. Të ardhurat e kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 1 799 943 lekë.

5. **Hekuran Seit Shqipe** banues në fshatin Kokël, Njësia Administrative Kodovjat, familje e përbërë nga dy të moshuar të cilë të dy marin Kemp invaliditeti. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 9 999 81.845 lekë.
6. **Koçi Mahmut Bengu** banues në fshatin Kodovjat, Njësia Administrative Kodovjat, familje e përbërë nga 4 anëtarë dy janë me Kemp invaliditeti. Familje që trajtohet me ndihmë ekonomike. Vlera e preventivit të banesës është 1 399 474.92.
7. **Martin Agim Arapi** banues në fshatin Bërsnik Sipër, Njësia Administrative Kodovjat, familje e përbërë nga 6 anëtarë. Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 1 799 991.83 lekë.
8. **Mustafa Sali Dedja** banues në fshatin Posnovisht, Njësia Administrative Kodovjat, familje e përbërë nga 3 anëtarë. Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 1 199 789.65 lekë.
9. **Skënderije Maliq Qyra** banuese në fshatin Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, familje e përbër nga dy persona, nga të cilët një është pensioniste dhe një si punëkërkuese. Familje pa të ardhura. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 999 946.85 lekë.
10. **Qemal Laver Tarko** banus në fshatin Irmath, Njësia Administrative Kukur, familje e përbërë nga 3 anëtarë, nga të cilët dy janë me Kemp invaliditeti. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 1 199 800.63 lekë.
11. **Flutura Sefer Kula** banuese në fshatin Sotir, Njësia Administrative Kushovë, familje e përbërë nga dy anëtarë. Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 999 956.498 lekë.
12. **Izet Haxhi Rrodhe** banues në fshatin Ulovë, Njësia Administrative Kushovë, familje e përbërë nga dy anëtarë, nga të cilët një pensionit dhe një trajtohet me Kemp invaliditeti. Vlera e preventivit të hartuar e banesës është 999 981.68 lekë.
